



PROCESVERBAL
Nga mbledhja e IX-të (VIII-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal
në Vushtrri, mbajtur më 29.7. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, përveç Naile Osmanit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), Abdulaziz Hoxha, komandant i policisë në Vushtrri, dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile. Para fillimit të mbledhjes, u mbajt një minutë heshtje, në shenjë nderimi të jetës dhe veprës së arsimitarit Halil Kuqi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi- propozoi që pikat 7 dhe 8 të hiqen nga rendi i ditës, duke e arsyetuar që këto pika kur është dashtë t'i nënshtrohen diskutimit publik, arsimitarët janë në pushime, prandaj ishte e pamundur që t'u ofrohen shkollave dhe të bëhen plotësime të tjera. Pastaj njoftoi se është edhe një propozimvendim për ridestininim të mjeteve që ka ardhur nga Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Buxhet, që duhet ridestinuuar mjete për vazhdimin e asfaltimit të rrugës Vushtrri-Dobërllukë. Gjithashtu është edhe një Informatë nga Drejtoria e Prokurimit lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronave të Komunës.

Muharrem Shabani- në emër të grupit asambleistë të AAK-së, propozoi miratimin e një deklaratë të Kuvendit, pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për rigjykimin e pjesshëm të kryetarit të AAK-së, Ramush Haradinaj, dhe lexoi këtë:

DEKLARATË

1. Kuvendi i Komunës në Vushtrri shprehë shqetësim dhe kundërshton vendimin e Tribunalit të Hagës për rigjykim të pjesshëm të z. Ramush Haradinaj, Kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

2. Kuvendi i Komunës konsideron se ky vendim është i padrejtë kur dihet se Tribunali me vendim unanim, me datën 03.04.2008 z. Haradinaj e kishte liruar nga të gjitha pikat e akt-akuzës dhe e kishte shpallur të pa fajshëm.
3. Kuvendi, kërkon publikisht nga institucionet kompetente qendrore vendore dhe ndërkombëtare që të ndërmarrin masat e mundshme për mbrojtje në liri të z. Haradinaj.
4. Duke besuar në pafajësinë e plotë të z. Haradinaj të dëshmuar sikurse edhe në rastin e parë që u shpall plotësisht i pafajshëm nga Triunali i Hagës, kuvendi beson se edhe në këtë rast drejtësia do të triumfoj, kur dihet se e gjithë puna dhe veprimtaria e tij gjatë luftës në Kosovë ishte në frymën e luftës së drejtë të UÇK-së për çlirimin një herë e përgjithmonë të Kosovës nga Serbia.

Në vazhdim deklaratën në fjalë e mbështetën të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

Ferit Idrizi- propozoi që deklarata për rastin Haradinaj të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

Pastaj vazhdoi debati për rendin e ditës:

Bahrije Pllana- propozoi që në "eventuale" të na informon drejtori i shërbimeve publike lidhur me mungesën e ujit të pijshëm, edhe përkundër faktit se në seancën e kaluar, kryeshefi i kompanisë regjionale na tha se ka ujë mjaft në rezervuaret e Komunës sonë. Poashtu propozoi që të shqyrtohet kompensimi i delegatëve të kuvendeve komunale. Në fund kërkoi që të kenë një Informatë nga drejtori kompetent për fushatën e korrje-shirjeve.

Zeqir Hasani- sa i përket propozimit që e kanë marrë nga Drejtoria e Prokurimit, tha se formimi i komisionit mbi shqyrtimin e propozimit për dhënie në shfrytëzim të tokës komunale, që është formuar edhe komisioni për shqyrtimin e kritereve, shtoi se ky vendim nuk ka qenë i përfunduar dhe se Drejtoria e Prokurimit nuk e ka marrë të përfunduar këtë vendim mbi caktimin e kritereve. Pastaj tha se kjo dhënie në shfrytëzim të pronave nuk ka të bëjë me miratimin e ligjit mbi partneritetin publiko-privat dhe koncesionim, pasi kjo shkon drejtpërdrejt në formë të tenderimit dhe konkurrencës së hapur.

Ferit Idrizi-

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi njëzëri aprovoi këtë:

Pika 7 dhe 8 të hiqen nga rendi i ditës, pastaj të përfshihen në rend dite propozimet e paraqitura nga Ferit Idrizit, kurse në "eventuale" të inkorporohen propozimet e Bahrije Pllanës.

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i propozim-deklaratës nga grupi asambleistë i AAK-së për rastin Haradinaj.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Jashtëzakonshme e KK-së dt.09.06.2010.
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, të datës 24.06.2010.
4. Informatë për situatën e sigurisë në komunë për 6 mujorin e parë të këtij viti. (referues Komandanti i Stacionit Policor).
5. Shqyrtimi i dytë i Draft-Rregullores për dhënien e tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin – vendosjen e objekteve të përkohshme.
6. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria e Prokurimit lidhur me pengesat në zbatimin e vendimit të KK-së, nr. 127/10, dt. 27.05.2010.
7. Shqyrtimi i raportit për situatën ekonomiko financiare dhe zbatimin e planeve investuese të komunës për periudhën janar-qershor 2010.
8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave vetanake për periudhën janar-qershor 2010.
9. Propozimvendim për ridestinim të mjeteve buxhetore në shumë prej 86.000 €.
10. Shqyrtimi i informatës për suksesin e nxënësve në fund të gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2009/2010.
11. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e pronave të pa luajtshme.
12. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoha komunale.
13. Shqyrtimi i propozim – marrëveshjes për ndërrim të pronave të paluajtshme.
14. Shqyrtimi i propozim-vendimit për lejim të mjeteve financiare për pagesë të shujtës për shërbyes civil të Administratës së Komunës.
15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira për renovimin e objektit të komunës.
16. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për ridestinim të mjeteve – shuma 9.800.00 €, për furnizim me orendi për zyrën e kryetarit.
17. Eventuale:
 - a. Informatë për furnizimin me ujë të pijshëm.
 - b. Informatë për fushatën e korrje-shirjeve.
 - c. Çështja e Spitalit në Vushtrri.
 - ç. Kërkesë për ngritje të kompensimit mujor për anëtarët e Kuvendit Komunal.
 - d. Pyetjet eventuale të anëtarëve të Kuvendit.

1. Shqyrtimi i propozim-deklaratës nga grupi asambleistë i AAK-së për rastin Haradinaj.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi e aprovoi Deklaratën në fjalë në mënyrë unanime.

Para se të bëj shqyrtimin e pikave tjera të rendit të ditës, fjalën e mori anëtari i Kuvendit, Pajazit Pllana, i cili paraqiti shqetësimin e tij lidhur me Spitalin “Sheik Zayed” në Vushtrri, duke thënë se janë shqetësuese zhvillimet e fundit në Spitalin “Shejkh Zajed” në Vushtrri, prandaj është e nevojshme që të të informohet Kuvendi dhe njëkohësisht të jemi në ngjarje të këtij procesi, pasi që Kuvendi Komunal i Vushtrrisë është themelues i Spitalit, bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Pastaj njoftoi se me 14.07.2010, drejtorinë e kanë lajmëruar se Ministria e Shëndetësisë dëshiron të bëjë një projekt për partneritet publiko-privat të shfrytëzimit të Spitalit, kurse ligji për partneritet publiko-privat në shëndetësi, akoma nuk është në funksion në Kosovë, kurse ditën e nesërme Sindikata

ka kërkuar sqarime për çështjen në fjalë. Gjithashtu njoftoi se këshilli profesional i Spitalit "Shejkh Zayed" nuk ka pranuar një formë të tillë të trajtimit dhe të marrjes së vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë për spitalin tonë, dhe këtë qëndrim të këshillit e kanë mbështetur të gjithë punëtorët. Mandej duke iu referuar memorandumit të mirëkuptimit i cili është i aprovuar nga Komuna e Vushtrrisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, tha se:

1. Spitali "Shejkh Zayed" nuk jepet as me qira; 2. Objekti në të cilin është ndërtuar Spitali (e që më herët ka qenë QKMF-ja) është pronë e Komunës, dhe objekti nuk mund të tjetërsohet; 3. Ai që ka dhënë donacion në vlerë prej 7 milionë marka gjermane, nuk ka pranuar që ky objekt të privatizohet, ose të merr formë tjetër, pra as me qira të ipet, sepse destinacioni është human. Pastaj tha se është menduar që në Spitalin "Shejkh Zayed" të realizohet një projekt pilot për neurokirurgji, por strukturat udhëheqëse, këshilli profesional dhe sindikata mendon se nuk guxon të preket substanca bazë e spitalit, pasi që është interes i madh qytetarë që ka arsyetuar edhe ekzistencën, dhe është në shërbim të të gjithë qytetarëve edhe të Vushtrrisë, por edhe të Mitrovicës. Gjithashtu ai tha se i drejtohet Kuvendit të Vushtrrisë që qytetarët e Vushtrrisë të mos mbesin në mes të Mitrovicës dhe Prishtinës, pasi që atëherë shërbimet shëndetësore të nivelit sekondar nuk do t'i marrin në mënyrën qysh i marrin këtu, duke shtuar se në periudhën prej që ekziston spitali, ka kryer 6.322 operacione, 6.379 lindje, ka bërë 82.722 ditë mjekimi, ndërsa ka pasë 24.750 pacientë, prandaj tha se qyteti i Vushtrrisë duhet ta ketë spitalin e vet. Në vazhdim tha se shqetësimi është sepse këtu ka interesa parciais, grupe të cilët kanë dashtë nëpërmjet saj me shfrytëzuar dhe për herë të parë në Kosovë me hy me partneritetin publiko-privat në një spital që është bërë me donacion.

Bajram Mulaku- tha se është i njoftuar për këtë iniciativë, duke e përkrahur plotësisht fjalimin paraprak të anëtarit të Kuvendit, Pajazit Pllana.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Jashtëzakonshme e KK-së dt.09.06.2010.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
Aprovohet njëzëri procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, pa vërejtje dhe sugjerime.

3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, të datës 24.06.2010.

Bahrije Pllana- tha se në diskutimin e saj, para se të miratohet rendi i ditës, diskutimi i saj është përbërë prej dy fjalive, por fjalia e parë mungon dhe ka qenë kështu: "paraprakisht të kemi respekt ndaj atyre që e marrin fjalën".

Qazim Azemi- paraqiti vërejtje lidhur me dy deklaramime të tij, duke shtuar se ka thënë që nuk duhet të ketë paralele të shkollës speciale vetëm në qytet, por të ketë edhe nëpër fshatra. Poashtu paraqiti vërejtje lidhur me të njëjtën pikë të rendit të ditës, duke kërkuar që në vend të fjalisë "organe qeverisëse dhe komunale", të thuhet "organe qeverisëse dhe profesionale".

Në fund paraqiti vërejtje që materiali i seancave po vjen me vonesë tek anëtarët e Kuvendit të Komunës, duke kërkuar që në të ardhmen të vjen me kohë.

Besim Jashari- paraqiti vërejtje lidhur me diskutimin e tij në faqe 13, duke kërkuar që fjala "mbledhë" të korrigojohet me fjalën "mbjellë".

Xhylsime Feka- faqe 9, kur i është referuar nenit 21, tha se ka deklaruar se fjalia nuk është e formuluar në rregullore, nuk ka qenë e formuluar mirë, dmth ka qenë e pakuptimtë.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet me shumicë votash, me një votë “abstenim” procesverbali i mbledhjes së Kuvendit të Komunës, me vërejtje e paraqitura nga: B.Pllana, Q.Azemi, B.Jashari dhe Xh.Feka.

4. Informatë për situatën e sigurisë në komunë për 6 mujorin e parë të këtij viti. (referues Komandanti i Stacionit Policor).

Abdulaziz Hoxha- njoftoi se situata e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë në përgjithësi është e qetë, duke falënderuar të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, institucionet komunale, që po ndihmojnë vazhdimisht për ta mbajtur situatën ashtu siç duhet, dhe njëkohësisht po iu dalim në shërbim kërkesave të qytetarëve. Pastaj njoftoi për strukturën e stacionit policor në Vushtrri. Në vazhdim njoftoi se në nënstacionin në Prelluzhë është rritur numri i pjesëtarëve të policisë në 28 policë. Mandej lidhur me sigurinë, tha se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 janë paraqitur gjithsej 437 raste penale. Poashtu gjatë këtij gjashtëmujori ka një rast të vrasjes, pastaj janë tri raste të grabitjeve, mandej është një rast dhunimi, kundër pasurisë janë 244 raste (e që përfshihen vjedhjet, vjedhjet e rënda, mashtrimet). Janë 12 raste të dhunës familjare, 18 raste të armëmbajtjeve pa leje, 4 raste të tentativës për vetëvrasje. Mandej konkludoi se nga pasqyra e paraqitur, rastet kundër pasurisë po dominojnë më shumë, edhe përkundër veprimeve të ndërmarrura nga policia, duke shtuar se tani është viti i tretë që gjykatat nuk ua pranojnë lëndët të cilat nuk kanë natyrë urgjente, dhe janë afro 1300 raste që qëndrojnë nëpër zyrat e tyre në polici, duke mos pasur mundësi me iu drejtuar prokurorisë për personat që dyshohen se i kanë kryer veprat penale, dhe për shkak të mungesës së objektit të gjykatës, ata nuk pranojnë lëndët që janë në procedurë të rregullt, dhe kjo pamundëson posedimin e një pasqyre reale të punës së policisë. Ndërsa rastet që kanë të bëjnë kundër pasurisë, tha se një numër i madh i tyre ende ka mbetur i pazbuluar, përkundër identifikimit të disa grupeve të caktuara të personave që kanë kryer veprat e tilla. Lidhur me vetëvrasjet, tha se në vitet e fundit është rritur numri i vetëvrasjeve dhe tentativave për vetëvrasje, duke shtuar se shkaqet e vetëvrasjeve janë nga më të ndryshmet dhe mosha e tyre është kryesisht e re, duke apeluar që bashkarisht të ndikohet në parandalimin e dukurisë së tillë. Ndër rastet tjera, e përmendi edhe 58 rastet e prishjes së qetësisë publike brenda gjashtëmujorit në fjalë, pastaj janë 82 raste të aksidenteve në komunikacion, duke shtuar se janë duke punuar në vazhdimësi për të parandaluar dhe zvogëluar numrin e aksidenteve në komunikacion, dhe njoftoi se janë 1465 gjoba të shqiptuara në trafik, për shkak të kundërvajtjeve që i kanë shkaktuar vozitësit. Pastaj janë arrestuar 106 persona, të cilët më pasë janë dërguar në gjykatë për shkak të dyshimeve të bazuara që kanë kryer vepra të ndryshme penale, pastaj policia ka kryer 210 asistime për institucione, kompani dhe klube të ndryshme sportive. Poashtu njoftoi se në këtë gjashtëmujor kanë realizuar 1036 urdhëresa të Gjykatës Komunale për kundërvajtje, duke sqaruar se këto urdhëresa kanë qenë kryesisht për persona që kanë qenë të kërkuar për vuajtje të dënimit. Pastaj kanë realizuar 40 plane operative, dhe 18 plane veprimi. Mandej tha se në bashkëpunim me inspektorët komunalë kanë vepruar për vënie të rendit në qytet për segmente të caktuara. Pastaj shtoi se janë në implementim të planit veror, që përfshihen disa probleme që paraqiten në këtë kohë, duke filluar nga të shtëna me armë zjarri nëpër ahengje të ndryshme, e që për çdo vit po rezultojnë me viktima, mandej përmirësimi i situatës në trafik në këtë

periudhë kur vijnë edhe bashkatdhetarët dhe rritet numri i automjeteve në qarkullim, parandalimi i prishjes së qetësisë publike nga objektet e lira, pas orarit të punës. Në fund falënderoi Kryetarin e Komunës dhe përfaqësuesit e EULEX-it për ndihmën financiare për të funksionuar njësi të biçiklistëve me pajisje dhe uniforma. **Sabit Kadriu**- tha se është shqetësuese për qytetarët e Artakollit, pasi që magjistrallja e cila e lidh Vushtrrinë me Skenderajn nuk i ka shenjat e komunikacionit, dhe në një situatë të tillë vozitësit janë duke zhvilluar shpejtësi jashtëzakonisht të madhe, pastaj asnjëherë nuk ka parë ndonjë patrullë të policisë e cila do të duhej t'ua ndalonte ngasjen e automjeteve me shpejtësi të jashtëzakonshme. Në vazhdim kërkoi nga komandanti i stacionit të policisë që herë pas here të shkojnë patrulla policore dhe të merren masa ndaj vozitësve që ngasin automjetet e tyre me shpejtësi të jashtëzakonshme. Gjithashtu tha se është shqetësim i qytetarëve pasi që bëhet një kontrabandë e madhe me derivatet e naftës, dhe në këtë kontrabandë janë të përfshira struktura të ndryshme, dhe ka raste që këto bëhen nganjëherë edhe në prani të policisë dhe ka policë që bashkëpunojnë me ta dhe janë servis i kësaj kontrabande. Mandej tha se policia duhet ta lufton edhe miton nëpër institucionet qeveritare në Vushtrri. Mandej tha se në rrugën Duboc-Beçiq në mungesë të patrullave policore, dalin ordinerët dhe kontrollojnë njerëzit, poashtu iu dalin vajzave të shkollës dhe i joshin me para që t'i marrin me vete, prandaj këto raste nuk mund ta ruajnë sigurinë e qytetarëve. Në fund kërkoi që të ndalohet gjuajta me armë nëpër ahengje të ndryshme.

Esat Beka- tha se ka lypës që vijnë nga Shqipëria, që thuhet se ata lypës vijnë në mënyrë të organizuar, prandaj pyeti se çka ka ndërmarrë policia në këtë drejtim? Pastaj pyeti lidhur me fenomenin e vrasjeve dhe të plagosjeve të qytetarëve nga armët zyrtare?

Pajazit Pllana- paraqiti brengën e tij lidhur me vetëvrasjet, duke shtuar se pas luftës në Kosovë fenomeni i vetëvrasjeve është kapital, duke kërkuar që të gjendet forma dhe mënyra e tejkalimit të fenomenit në fjalë. Në vazhdim tha se mostrajtimi i gjendjes postraumatike në Kosovë, popullin e Kosovës e ka sjellë në një situatë shumë të vështirë, prandaj propozoi që policia së bashku me institucionet tjera relevante në Qendrën Klinike Universitare në Psikiatrinë të hulumtohet ky fenomen, të luftohet dhe të ofrohet aq sa kanë mundësi të bëjnë, pasi që shpëtimi i një jete ka domethënie shumë të madhe.

Xhemajl Pllana- pyeti komandantin e policisë se a ka informata që njerëzit e maskuar plaçkitin qytetarët midis Vushtrrisë, pasi që në Vushtrri brenda këtij muaji ka ndodhur një plaçkitje nga personat e maskuar, me ç'rast një çift i sapomartuar te varrezat e qytetit është plaçkitur dhe kërcënuar që të mos tregon. Pastaj tha se gjuajtjet me armë gjatë ahengjeve të ndryshme bëhen vazhdimisht, dhe nuk merren masa nga policia. Gjithashtu si shqetësuese paraqiti muzikën në dasma, e cila zgjatë me ditë dhe netë të tëra, duke penguar dhe prishur qetësinë e të tjerëve.

Veli Karaça- tha se janë shqetësime të mëdha qitjet me armë gjatë ahengjeve, pasi që janë shumë të rrezikshme për popullatën, prandaj kërkohet një angazhim më i madh i policisë dhe përkrahje më e madhe nga qytetarët, duke shtuar se ka raste kur kalimtarët e rastit mbesin invalidë nga pakujdesia ose papërgjegjësia e disa njerëzve, që shpeshherë një pjesë e tyre janë edhe zyrtarë, prandaj kjo është një dukuri që mund të ndalohet, pasi që nuk është diçka që nuk shihet. Në fund tha që bashkarisht me policinë duhet ta luftojmë dhe parandalojmë fenomenin e tillë.

Nysret Gërxhaliu- kërkoi sqarimet lidhur me kërkesat e qytetarëve të rrugës "Tirana", të cilët para një viti iu kanë drejtuar Komunës për vendosjen e pengesave, pasi që në rrugën "Tirana" zhvillohet një shpejtësi jashtëzakonisht e madhe, e cila e rrezikon jetën e fëmijëve që qarkullojnë në rrugën në fjalë, prandaj kërkoi nga komandanti i policisë që të siguron një patrullim edhe më të gjatë në rrugën në fjalë.

Besim Jashari- lidhur me kodin e standardeve profesionale në polici, tha se një koordinim dhe bashkëpunim i ngushtë me institucionet tjera, sikur që është rasti ne

inspektionin në Komunë është më se i nevojshëm. Pastaj lidhur me çështjen e bashkëpunimit me qytetarët, tha se është për keqardhje kur qytetari informon policinë ose inspektionin për një rast, kurse policia ose inspektioni kur del për një rast me reaguari thotë se nuk do të reagojnë, por ka pasë një lajmërim për reagim, prandaj kjo është arsyeja që njerëzit nuk po raportojnë, pasi që polici e vë në një pozitë të palakmueshme qytetarin, dhe për këtë arsye kërkoi që policia ose inspektioni ta ruajnë qytetarin që raporton, sepse ai është bashkëpunëtor i policisë ose inspektionit.

Muharrem Shabani- tha se komunikimi i Komunës me policinë përmes formave të organizimit të KKSB-së, Komitetit për Komunitete, nuk e dijnë se sa mbledhje janë mbajtur dhe çfarë tema janë shqyrtuar, edhe pse përmes tyre duhet të jetë lidhshmëria dhe është obligim i raportimit të rregullt ligjor në Kuvend, dhe shtoi se kanë kaluar dy vite e gjysmë që nuk ka raportim fare në këtë Kuvend për çështjet dhe dukuritë që e tangojnë policinë dhe kërkohet ndihma e Kuvendit dhe strukturave tjera që Kuvendi i menaxhon. Pastaj pyeti komandantin e policisë se sa kërkesa me shkrim ka drejtuar policia organeve komunale gjatë patrullimeve në terrenin e Komunës? Mandej tha se një element shumë me rëndësi është preventiva, pra çka po ndërmerret për dukuritë e caktuara që po paraqiten. Në fund kërkoi që të ketë raporte tremujore nga policia për gjendjen e përgjithshme në Komunën e Vushtrrisë.

Sami Istrefi- tha se vlerëson lartë krijimin e njësisë së patrullimit të biçiklistëve, pasi që njësi në fjalë është duke kryer punë të mira dhe të ndershme, duke shliur komunikacionin, pasi që ka qenë tepër i ngarkuar, sidomos në stinën e verës, kur po vijnë shumë mërgimtarë me automjete. Pastaj si shqetësim paraqiti edhe mbrojtjen e shkatërrimit të pyjeve, pasi që ka raste kur pyjet në Komunën tonë po shkatërrohen, duke kërkuar që bashkarisht me Komunën të merren hapa konkret dhe të zgjidhen këto probleme. Mandej falënderoi policinë për inspektimin dhe menaxhimin e mirë gjatë shënimit të datave të ndryshme me rëndësi shtetërore dhe komunale.

Habib Mustafa- pyeti se cila është struktura nacionale në stacionin e policisë në fshatin Prelluzhë? Pastaj informoi se qytetarët e anës së Çyçavicës kanë vendosur që në mënyrë private me drunjë ta fillojnë ndërtimin e urës mbi lumin Sitnica, pasi që kanë kaluar 12 vite që nuk po mund ta shfrytëzojnë rrugën që e kanë shfrytëzuar me shekuj, prandaj kërkoi edhe nga Kryetari i Komunës, por edhe nga policia që informatën në fjalë ta marrin seriozisht dhe të merren masa që ajo urë të ndërtohet në mënyrë institucionale.

Bajram Mulaku- tha se është shumë i rëndësishëm raportimi nga ana e komandantit të stacionit të policisë në Vushtri, duke përkrahur propozimin që raportimi para Kuvendit të bëhet çdo 6 muaj, e nëse është e nevojshme edhe më shpesh. Pastaj tha se shqyrtimi i sigurisë për Komunën e Vushtrrisë bëhet në zyrën e Kryetarit, çdo muaj në mënyrë të obligueshme dhe zyrtare në KKSB, me ç'rast në këto takime vazhdimisht vlerësohet se siguria e të gjitha komuniteteve është e mirë në Komunën tonë. Pastaj tha se Komuna e Vushtrrisë ka një bashkëpunim të mirë me policinë, dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi kanë kryer shumë punë bashkarisht, dhe në veçanti e përmendi bashkëpunimin e mirë në mes të policisë dhe Drejtorisë së Inspektionit, për të gjitha fushat, pasi që edhe kanë plan të përbashkët të veprimit. Mandej tha se qitja me armë është brengë e të gjithëve, por është duke u reduktuar një fenomen i tillë, pasi që policia ka hartuar një plan veprimi për një gjë të tillë, dhe kërkoi që plani i veprimit të policisë të jetë permanent. Gjithashtu e përkrahu bashkëpunimin e qytetarëve me policinë, duke kërkuar që të intensifikohet bashkëpunimi i tillë edhe në të ardhmen. Mandej falënderoi idenë e policisë së EULEX-it për formimin e njësisë së biçiklistëve, pasi që ky njësi po jep frytet e punës në mbajtjen e rendit dhe qetësisë në Komunën e Vushtrrisë. Poashtu falënderoi policinë që gjithmonë iu kanë përgjigjur thirrjeve për të qenë prezent në mbajtjen e rendit dhe qetësisë gjatë shënimit të datave të rëndësishme.

Abdulaziz Hoxha- lidhur me raportimin para Kuvendit, paraqiti gatishmërinë e tij që të raporton në çdo kohë. Sa i përket pyetjes lidhur me magjistralen në Duboc, tha se prej vitit të kaluar të muajit dhjetor policia e ka formuar një plan operativ, dhe ai plan ka dy qëllime: për shkak të shtimit të numrit të vjedhjeve dhe ka pasë shumë kërkesa të banorëve për kundërvajtjet në trafik që janë shkaktuar nga vozitësit, dhe secili ndërrim është i obliguar që dy herë gjatë ndërrimit minimum një orë për të qëndruar në atë aks rrugor. Kurse sa i përket kontrabandës, tha se vetëm gjatë vikendit policia ka konfiskuar 11.000 litra derivate të naftës, duke shtuar se brenda këtij gjashtëmujori tre zyrtarë të policisë janë suspenduar vetëm pse kanë qenë të dyshuar për përfshirje në kontrabandë. Ndërsa lidhur me rastet e qitjeve me armë zjarri, tha se plani ka filluar javën e kaluar dhe kanë qenë dy raste që policia ka kryer kontrollin, dhe në të dyja rastet kanë gjetur armatim, në njërin rast një zyrtar policor, i cili është suspenduar për shkak se ka pasë dasëm, poashtu një javë më parë janë konfiskuar gjashtë armë gjatë ditës së diel. Mandej njoftoi se nga java e kaluar janë rreth 100 pjesëtarë të policisë së Kosovës në gjendje gatishmërie për të kryer kontrollime nëse ka të shtëna me armë zjarri, duke përfshirë edhe njësitin e qenve. Lidhur me lypësit, tha se kanë pasur një plan që ende vazhdon, dhe shtoi se tash ka më pak lypës, dhe nuk janë të gjithë lypësit nga Shqipëria, kurse lypësit nga Shqipëria me vendim të gjykatës për kundërvajtje policia i transferon në kufi, por kohë pas kohe përsëri vijnë të tjerët. Pastaj shprehu keqardhje që po ndodhin raste të vrasjeve nga armët zyrtare të policisë, duke shtuar se trajnime bëhen vazhdimisht, dhe nëse do të respektoheshin ato trajnime, asnjëherë nuk do të keqpërdroreshin armët zyrtare. Sa i përket vetëvrasjeve, tha se është shumë shqetësues ky fenomen, dhe kryesisht janë të moshave të reja. Kurse për njerëzit me maska, tha se nuk ka dëgjuar për rastin e paraqitur nga anëtari i Kuvendit Xh. Pllana. Ndërsa duke iu referuar asaj që u tha se po ndalen qytetarët nga njerëzit e maskuar, u përgjigj se nuk kanë raporte, duke e përmendur një rast që ka ndodhur në vitin 2007, kur janë paraqitur disa njerëz me maska në Pestovë, në emër të AKSH-së, pastaj policia ka ndërmarre masa dhe nuk ka ndodhur më asnjë rast tjetër. Në vazhdim lidhur me kërkesën për vendosjen e pengesave në rrugën "Tirana", tha se kanë pasur edhe kërkesa për të dërguar patrulla policore, por njëkohësisht shtoi se është e pamundur në çdo rrugë të vendosen patrullime policore. Ndërsa lidhur me kodin e policisë, tha se është e vërtetë që disa policë nuk po e respektojnë kodin në fjalë, duke shtuar se po mundohen që ato raste me i eliminuar. Gjithashtu bëri të ditur se Komunës i kanë bërë shumë kërkesa, ka raste kur janë bërë me shkrim, por edhe drejtpërdrejt. Mandej lidhur me narkotikët nëpër shkollë, u përgjigj se nuk ka shumë probleme, pasi që për dy vite që janë vendosur nëpër shkollë policët me rroba civile, mund të krenohen sepse situata është shumë e mirë. Ndërsa lidhur me pyjet, tha se në bashkëpunim me autoritetet pyjore janë duke punuar për të marrë masa, por autoritetet pyjore kanë shumë probleme, pasi që ata nuk kanë pajisje, nuk kanë punëtorë të mjaftueshëm. Në fund lidhur me strukturën e policisë në Prelluzhë, u përgjigj se 9 policë janë serbë, kurse 7 janë shqiptarë, ndërsa 12 të tjerë janë sjellë përkohësisht për shkak të rrethanave të krijuara në drejtorinë rajonale në Mitrovicë, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

5. Shqyrtimi i dytë i Draft-Rregullores për dhënien e tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin – vendosjen e objekteve të përkohshme.

Ismet Gashi- paraqiti vërejtje duke thënë se në shqyrtimin e parë kur ka qenë kjo draftrregullore, e ka përgëzuar drejtorin e drejtorisë që ka shkuar në mënyrë formale ashtu siç duhet, kurse draftrregulloren që ka ardhur për herë të dytë në shqyrtim nuk është e përgatitur në mënyrë formale sikur herën e parë. Pastaj paraqiti vërejtje draftrregulloret që vijnë në Kuvend pas diskutimit publik, vijnë pa

një përmbledhje të debatit për vërejtjet prej qytetarëve ku është mbajtur diskutimi publik, që t'i bashkëngjiten draftit ato që janë inkorporuar, dhe të precizohet se cilat janë marrë parasysht. Në vazhdim paraqiti vërejtje të neni 6.1, dhe tha se duhet të jetë kështu: “që konkursi duhet të jetë i shpallur më së paku në dy mediat e shkruara”. Pastaj kërkoi që neni 11.5 ose të hiqet, ose ta riformulon ndryshe Avokati i Komunës, pasi që nuk është në rregull një komision ta anulon vendimin e Kuvendit. Mandej të neni 44, kërkoi që fjalia “leje përdorimi” të zëvendësohet me fjalinë “leje ndërtimi”.

Sabit Kadriu- kërkoi që gjatë zbatimit të rregullores në fjalë të kontrollohet, pasi që ka raste kur Kuvendi i Komunës i ka lejuar dikujt që ta ketë në shfrytëzim, por objektet gjatë ndërtimit nuk i respektojnë konditat që janë të përfshira në draftrregulloren në fjalë, duke përmendur rastin në Stanoc, ku tani ndërtohet me material shumë të fortë, ndërsa ajo është në shfrytëzim.

Nystret Gërxhaliu- pyeti se a ekziston dhe ku hapësira për qëllimet që përshkruhen në draftrregullore?

Idriz Ismajli- lidhur me pyetjen e N.Gërxhaliut, u përgjigj se i kanë hapësirat që janë tani, mirëpo me planet rregulluese të qytetit do të parashihen edhe hapësira të reja aty ku ka mundësi në mënyrë që t'iu ndihmohet bizneseve të vogla që të merren me një veprimtari të caktuar.

Sami Istrefi- kërkoi nga drejtori që në këtë rregullore të specifikohen edhe billboardat, panot, dhe ato pano që duhet të kenë leje, dhe në këtë mënyrë të eliminohen panot që janë të vendosura në vende të papërshtatshme. Pastaj kërkoi që të identifikohen edhe kabinat lëvizëse dhe të vëhen nën një rregull juridik.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja në fjalë duke përfshirë vërejtjet dhe sugjerimet e diskutuesve.

6. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria e Prokurimit lidhur me pengesat në zbatimin e vendimit të KK-së, nr. 127/10, dt. 27.05.2010.

Fadil Muzaqi- paraqiti sqarimet hyrëse.

Zeqir Hasani- duke iu referuar sqarimeve hyrëse nga drejtori, tha se nuk janë ato arsye, pasi që pikat që janë caktuar nga komisioni, kanë qenë të aprovuara nga ana e anëtarëve të komisionit, dhe kryesuesi i komisionit ka qenë i obliguar që pas takimit të komisionit, pikat që duhet të merren në rast të tenderimit të këtyre parcelave, t'iu dërgohet nga një kopje secilit anëtarë të komisionit, por kjo nuk ka ndodhur, prandaj konsideron që shtyrja e këtij propozimi për mosqitje në tenderim nuk ka të bëjë me ligjin mbi partneritetin publiko-privat, sepse këtu nuk ka bëjë me investime të përbashkëta Komunë-biznes privat.

Refik Ramaj- tha se çështja në fjalë asnjë element nuk e ka të përbashkët me partneritetin publiko-privat, sepse është një çështje krejt tjetër, prandaj nuk ka arsye që kjo të shtyhet.

Ferit Idrizi- u pajtua se kjo çështje nuk ka të bëjë me partneritetin publiko-privat, por pasi që Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë nuk e ka proceduar për të shpallur tender për dhënie në shfrytëzim me arsyetimin se ligji për dhënie në shfrytëzim është në procedim e sipër në Parlamentin e Kosovës, krejt kjo ka shkuar për qëllimin më të mirë për ta nxitur konkurrencën, prandaj kërkoi që të ndërrohet neni ku thuhet se obligohet Drejtoria e Prokurimit që ta tenderon, ndërkaq kjo le t'i procedohet Drejtorisë së Bujqësisë, derisa të del ligji, dhe tërë ato kompani që janë të interesuara le t'i paraqet në këtë Kuvend dhe Kuvendi le të vendos.

Bajram Mulaku- tha se kjo është një çështje delikate, sepse shumë pak është arritur me proceduar prona komunale për shfrytëzim atyre që kanë qenë të interesuar. Pastaj njoftoi që prej që është bërë Kryetar i Komunës, ia kanë dhënë në shfrytëzim

një pronë në Nadakoc një kompanie zvicerane dhe një vendore, dhe kanë punuar diçka, por nuk është i kënaqur me dinamikën e punëve të tyre, por në kontratë në mënyrë recidive e ka të shkruar se nëse deri më 10 gusht nuk kryen punët, atëherë të gjitha investimet i mbesin Komunës. Pastaj paraqiti interesimin që të kryhet sa më parë fabrika e qumështit i nevojitet tërë Komunës, dhe pastaj fermerët kanë ku t'i plasojnë prodhimet e tyre, por edhe dikush do të punësohet aty. Mandej një ndër sukseset përmendi edhe gjelbërimin të Ura e Gurit, që është dhënë në shfrytëzim me tenderim.

Muharrem Shabani- lidhur me këtë çështje që erdhi në rend dite brenda ditës, tha se është për të dyshuar nëse është reale dhe normale, pasi që po të ishte diçka normale, do të vinte në procedurë të rregullt. Pastaj ripërsëriti qëndrimin se ajo pjesa e epërme që ka qenë 40 ari, le të shkon ajo, kur kjo që po dëshirohet tani, në procedurë të shkurtë, pa formë konkrete të propozimit të vendimit, vetëm me një shkresë, që nuk dihet asgjë cilat nuk kriteret, si mund të bëhet deklarimi i anëtarëve të kuvendit. Në fund tha se grupi samblistë i AAK-së nuk mund të vepron kundër ndërgjegjes.

Samir Istrefi- tha se këtu po propozohet që të ndryshohet një nen, dhe ai nen është më i favorshëm për komisionin që e ka formuar ky Kuvend, se sa ai nen që figuron në propozimvendimin e Kuvendit, prandaj në bazë të kësaj propozoi që ai nen të plotësohet dhe të hiqet neni që e obligon Drejtorinë e Prokurimit, dhe të vendoset Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi, dhe mbi bazën e kësaj të vepron në formën e ofertimit, duke shtuar se transparenca më e mirë e këtyre 10 viteve të fundit është kjo, që janë pozitive dhe opozitive brenda.

Refik Ramaj- tha se ai nen mund të ndërrohet, por ai komision nuk ka bazë ligjore me autorizim Drejtorinë për Ekonomi dhe Bujqësi për të zhvilluar procedura të prokurimit. Kurse ajo që mund të bëhet nëse vendoset me prit ligjin deri në aprovim, është që Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi sipas planit strategjik të zhvillimit me i ftuar bizneset për të dorëzuar biznes plane dhe mandej me njoftuar Kuvendin se për një lëmi të caktuar ka kaq biznes plane të dorëzuara, kurse me zhvilluar procedura të prokurimit bëhet shkelje e rëndë ligjore.

Bajram Mulaku- tha se është i interesuar edhe vet që ta gjen formën ligjore për çështjen në fjalë, pasi që pa formën ligjore nuk nënshkruan asgjë.

Besim Jashari- lidhur me çështjen në fjalë, propozoi që drejtori përkatës apo Avokati i Komunës të shkojnë dhe t'i shikojnë praktikat tjera në Komunën e Prishtinës dhe të kërkohet ndihmë që të arrihet deri tek një zgjidhje.

Refik Ramaj- propozoi që kërkohen biznes plane prej bizneseve dhe prej atyre që janë identifikuar që janë të interesuar, le t'i dorëzojnë në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, dhe nëse ka një transparençë, le të tejkalohej edhe ligji, duke u formuar një komision i përbashkët i cili i cakton kriteret.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 23 vota "për", 7 "kundër", dhe 1 "abstenim" lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
Aprovohet vendimi me të cilin ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës për shpalljen e tenderit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës, 01Nr.127/20, dt.27.05.2010, si vijon:

- a. *Në emërtimin e vendimit fshihen fjalët: "shpalljen e tenderit për"*
- b. *Në nenin 1 rreshtin e parë fshihen fjalët: "shpallja e tenderit për"*
- c. *Heqet neni 4 i vendimit i cili ndryshohet.*

Sqarim: grupi asambleistë i AAK-së ka votuar "kundër".

7. Shqyrtimi i raportit për situatën ekonomiko financiare dhe zbatimin e planeve investuese të komunës për periudhën janar-qershor 2010.

Bajram Mulaku- fillimisht tha se është e pamundur që në një raport të përfshihet puna gjashtëmujore. Pastaj tha se qëllimi i tij ka qenë që të realizon të gjitha ato projektet kapitale që nga viti i kaluar kanë qenë në zhvillim, por kanë qenë të papërfunduara. Poashtu qëllimi tjetër ka qenë realizimi i të gjitha projekteve të vitit të kaluar, që kanë mbet për realizim për këtë vit. Pastaj tha se ka qenë qëllim i tij që të realizohen të gjitha ato projekte të planifikuara vitin e kaluar, për këtë vit, edhe me mjete të grantit qeveritar, ose të brendshëm, dhe këto përsëri ndahen ato që janë planifikuar vitin e kaluar për këtë vit, në projekte që kanë qenë donacion prej Qeverisë ose donatorë të tjerë, që kanë qenë të planifikuara për realizim përmes mjeteve të qeverisë dhe kuvendit, projekte për realizim përmes mjete të kuvendit komunal, ose nga kuvendi dhe participimi i qytetarëve. Pastaj projektet që janë planifikuar të realizohen ose nga qeveria, ose nga donatorët tjerë janë: fabrika e përpunimit të ujit të pijshëm në fshatin Balinc, duke sqaruar se tenderi është shpallur, por nuk kanë filluar punët, janë ndarë 4 milionë e 950 mijë euro, është në vlerësim tenderi; gjithashtu është në ndërtim e sipër qendra kryesore e mjekësisë familjare, e cila kushton rreth 1 milionë euro; ndërtimi i shkollës së re të gjimnazit në Vushtrri, i cili është investim i qeverisë me rreth 2 milionë euro; është në procedim restaurimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit si projekt dy vjeçar; ndërtimi i Kullës së Azem Bejtës; restaurimi dhe hulumtimi në Kalanë e qytetit, i cili është projekt dy vjeçar, e që nuk e ka në menaxhim Komuna; rruga Beqiq-Duboc, në vlerë rreth 700.000 €, investim i qeverisë, është e kryer; rruga Vërmicë-Kollë është në zhvillim, në vlerë rreth 650.000 €; rruga që ka qenë e planifikuar me qeverinë Rashanë-Sumë, në gjatësinë mbi 4 kilometra, këtë vit vet Komuna i ka investuar 100.000 €, kurse mjetet që kanë tepruar janë investuar në të njëjtin projekt edhe në krahun tjetër; rruga Galicë-Duboc është në zhvillim e sipër. Në vazhdim numëroi edhe për disa projekte tjera që janë në zhvillim e sipër. Pastaj njoftoi se qëllimi kryesor ka qenë që të ketë sa më shumë të hyra vetanake brenda këtij gjashtë mujori, duke shtuar se 26.46 % janë realizuar të hyra më shumë se sa që janë planifikuar. Pastaj kërkoi që Kuvendi t'ia jep të drejtën për mjetet që teprojnë nga projektet e ndryshme me i transferuar në projekte të ndryshme që janë në interes të Komunës.

Refik Ramaj- duke iu referuar shqyrtimit të raportit në fjalë, tha se mungon komplet pjesa e parë për situatën ekonomike, pasi që flitet vetëm për situatën financiare dhe zbatimin e planeve në Komunë, kurse nuk flitet për situatën ekonomike në Komunë, pasi që situata ekonomike në Komunë përfshinë shumë më shumë se sa administrata komunale dhe operimet e saj me paratë publike, prandaj raporti do të duhej ta jepte një syzhe të qartë se çfarë rrethine ekonomike është krijuar për linjën dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën tonë. Pastaj tha se situata ekonomike nënkupton daljen më të dhëna konkrete nga qeveria dhe kryetari, cilat kanë qenë burimet e financimit edhe në bizneset private, por edhe në ekonomitë familjare. Mandej tha se mungojnë shënime për aksionet e shitura nga kompanitë vushtrriase, nuk ka shënime sa është investuar kapital i huaj në bizneset e Komunës së Vushtrrisë, sepse kjo është edhe një poentë e marketingut tek investitorët e ardhshëm, pasi kapitali i huaj ka filluar kaher të investohet në Vushtrri, dhe ai po multiplifikohet suksesshëm. Gjithashtu një vlerësim i aseteve dhe ekuitetit të kompanive të Komunës së Vushtrrisë; një pasqyrë e likuiditetit të kompanive vushtrriase, dhe sipas kësaj analize të merren edhe masat tek taksat, ngarkesat dhe tek lehtësirat tjera që janë sipas kompetencave të Komunës; shënime për vëllimin fizik të eksporteve vushtrriase dhe një diversitet të produkteve; gjithashtu vlerat financiare të eksportuara nga komuna jonë; një shënim matës për joshjen e investimeve; lehtësirat administrative që ka aplikuar Komuna për këtë gjashtëmujor; lista e shërbimeve konsulente që ka ofruar Komuna në këtë gjashtëmujor dhe impakti në afarizmin e bizneseve, ose autputet që kanë dalë nga kjo konsulentë që kanë ofruar shërbimet profesionale të Komunës; cilat janë veprimet konkrete të Komunës për përmirësimin e ambientit ndërmarrës si dhe cilët janë treguesit matës që e konfirmojnë këtë; cila është vlera e përafërt e rimitancave

të velura nga mërgata jonë, dhe impakti i tyre në zhvillimin e ekonomive familjare dhe në lindjen e bizneseve të reja; cilat nga ndërmarrjet e Vushtrrisë u shpallën ndër 20 tatimpaguesit më të mëdhenj të Republikës së Kosovës. Është dashtë të raportohet se sa pyetësorë janë aplikuar deri tash, cilat janë rezultatet, cilat janë nxitjet e zhvillimit nga këta pyetësorë. Lidhur me subvencionet, tha se dhënia e tyre për serra, nuk e nxit fare zhvillimin ekonomik, por ato janë vetëm një ndihmë emergjente për familjet me nevojë. Mandej nëse vlerësohet buxheti i rishikuar, tha se subvencionet dhe investimet kapitale janë dy indikatorët kryesor të performancës së Komunës, kurse te buxheti i shpenzuar, tha se tabelarët nuk përkojnë, pasi që ka dallime të mëdha në mes shifrave të raportit mujor i drejtorisë, pra për të njëjtin send flet Komuna me dy shifra të ndryshme. Në vazhdim tha se në raport nuk është përmendur uji industrial, i cili është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve dhe është shumë më i lirë. Pastaj e konsideroi si të arritur të Komunës Rregulloren për racionalizimin e ujit. Ndërsa lidhur me higjienën në qytet, tha se nuk është konstatuar në raport që Komuna e Vushtrrisë është njëri nga qytetet më të papastërta në Kosovë. Gjithashtu nuk ka shifër konkrete se sa është atakuar prona komunale me numër të sipërfaqeve, me parcela, dhe të identifikohen njerëzit. Lidhur me bujqësinë, tha se subvencionet e kanë vendin e qëlluar nëse investimi i Komunës përmes donacioneve të huaja në depotë, ventilimin dhe ruajtjen afatgjate të patateve. Lidhur me arsimin, tha se në raport duhet të jenë treguesit e matshëm se sa është përmirësuar mësimdhënia dhe mësimnxënia në këtë periudhë. Gjithashtu tek shëndetësia paraqiti vërejtje që në raport nuk flitet se sa janë përmirësuar shërbimet shëndetësore. Mandej paraqiti vërejtje duke thënë që Komuna duhet të del me një shifër të përafërt lidhur me papunësinë, dhe strategjia për ta tejkaluar. Pastaj duke iu referuar parkut të biznesit në Lumëmadh, tha se është plotësisht i gabuar lokacioni dhe mënyra, duke shtuar se mungon një analizë se çfarë impakti ka në zhvillimin e tanishëm. Në fund rekomandoi Kryetarit të Komunës që të mos e qes në votim raportin në fjalë, duke kërkuar që të plotësohet akoma dhe të del një raport i mirë.

Bajram Mulaku- tha se raporti në fjalë është gjithëpërfshirës, mirëpo nëse dikujt i intereson raporti i një drejtorie të caktuar, bashkarisht mund të analizohet në detaje. Sa i përket papunësisë, tha se nuk ka ndonjë statistikë fikse, pasi që as enti nuk ka shënime të sakta, sepse nuk janë paraqitur të gjithë ata që kanë nevojë për punë. Pastaj duke iu referuar vërejtjes për pjesën ekonomike, u pajtua plotësisht, mirëpo dihen problemet me pronat komunale për të zhvilluar bizneset.

Muharrem Shabani- tha se raporti ka sambli, edhe raport, edhe program, kurse anëtarët e Kuvendit kanë raport para vetes, duke shtuar se në raport janë paraqitur 25 projekte të planifikuara, që nuk duhet të jenë pjesë e raportit, por duhet të jenë vetëm projektet e realizuara, prandaj nuk dihet se a është program apo raport. Mandej tha se çështjet që janë paraqitur nuk kanë shënime konkrete. Në vazhdim kërkoi që të dihet se sa është numri i bizneseve në Komunën e Vushtrrisë, sa përmbushin obligime, e sa nuk përmbushin, duke shtuar se edhe punëtorë të Komunës merren me biznese të pa regjistruara. Mandej duke iu referuar projektit në Nedakoc, tha se e kanë kërkuar me shkrim një kopje të kontratës për ta mësuar se cilat kanë qenë obligimet, por nuk kanë marrë asgjë, dhe përsëri kërkoi që të dihet si kanë qenë afatet, kushtet, konditat e atij projekti, sa është parashikuar që të punësohen, dhe të dihen në mënyrë të hapur çdo detaj.

Bajram Mulaku- tha se pajtohet që të identifikohen uzurpatorët e pronave. Pastaj tha se dihet numri i bizneseve, duke shtuar se Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi ka evidencë edhe për numrin e bizneseve pasive. Në vazhdim shprehu keqardhje nëse e kanë kërkuar kontratën e fabrikës së qumështit, dhe nuk ua kanë dhënë, pasi që gjithçka është transparente.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, të tjerët “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet raporti në bazë të vërejtjeve dhe sugjerimeve të diskutuesve.

Njëkohësisht Kuvendi i Komunës ia delegon përgjegjësitë Kryetarit të Komunës për marrje të vendimeve për ridestnim, përkatësisht shfrytëzim të mjeteve të lira të mbetura nga projektet e realizuara, në projekte tjera të planifikuara me vendim të Kuvendit të Komunës për vitin përkatës.

8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave vetanake për periudhën janar-qershor 2010.

Zeqir Hasani- së pari informoi për një gabim teknik në Informatë, ku thuhet për periudhën Janar-Mars. Mandej tha se sa i përket shfrytëzimit dhe shpenzimit të mjeteve nga fondet e cekura (10, 21, 22, 31), shihet se nga fondi 10 ecuria e shpenzimeve të mjeteve të dedikuara për investime kapitale ka marrë kahje të shpenzimit të pamjaftueshëm, pasi që ka mjete të pashfrytëzuara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, prandaj sugjeroi që të planifikohen mjetet dhe sa më mirë të shfrytëzohen mjetet të cilat janë për investime kapitale. Pastaj paraqiti vërejtje tek shpenzimi i mjeteve në mënyrë më të shpejt për mallra dhe shërbime. Gjithashtu paraqiti vërejtje lidhur me shpenzimin e mjeteve nga të hyrat vetanake për mallra dhe shërbime, pasi që kanë tepruar mjete nga fondi 10 për mallra dhe shërbime. Lidhur me fondin 22, u pajtua se janë shfrytëzuar afro 90 %. Ndërsa lidhur me mbledhjen e të hyrave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, tha se ka një mbledhje të mjaftueshme në krahasim me planifikimin, por paraqiti disa vërejtje sa i përket aktvendimeve lidhur me ngarkesat për taska komunale për firma, pasi që thuhet se janë 980 aktvendime të shpërndara, dhe nëse krahasohet me numrin total të bizneseve, del se janë 300 biznese të Komunës të pangarkuar me taksë komunale, ndërsa në bazë të Informatës në fjalë figuron se vetëm 90 biznese janë të pajisura me leje pune.

Besim Jashari- paraqiti vërejtje për mënyrën se si po adresohen informatat, duke shtuar se Informata në fjalë shkruan se kalon përmes Kryetarit, por do të duhej të ishte e nënshkruar nga Kryetari, por nuk është e nënshkruar. Pastaj tha se në tabelën në faqen 2, komentet që janë dhënë nën tabelë janë të mangëta, dhe tabela që është më sipër është mjaft e qartë dhe nuk ka nevojë për komente shtesë, pasi që komentet ipen për tabelat që mund ta dërgojnë në lajthitje anëtarin e Kuvendit, dhe si shembull tha se mjetet për komunalitet dhe subvencione që kanë qenë të parapara me grantin qeveritar, nëse nuk janë realizuar në periudhat e caktuara kohore, atëherë duhet sqaruar anëtarët e Kuvendit pse kanë mbet të lira. Në vazhdim lidhur me fondin 22, tha se duhet sqaruar pse një shumë e mjeteve kanë mbet të lira, dhe janë bartur nga viti paraprak. Mandej, duke iu referuar paragrafit të hijëzuar, në faqe 5-së, kërkoi sqarime se për çfarë arsye ka mbet kjo e dhënë në Informatën për realizimin e buxhetit për periudhën Janar-Qershor 2010. Gjithashtu, lidhur me faqen nr. 6, duke bërë krahasimin mes dy tabelave, duke pyetur pse nuk janë paraqitur shifrat e qartë edhe në tabelën e fundit, sikurse që janë paraqitur në tabelat faqe nr.6. Kurse sa i përket realizimit të të hyrave për periudhën Janar-Qershor 2010, këto kategori që janë paraqitur në tabelë, pyeti se a ka gurthyes dhe a ka miniera në Vushtrri? , nëse ka gurthyes a nuk ka asnjë të hyrë nga këta gurthyes. Mandej ndër kategoritë që nuk ka fare të hyra përmendi edhe reklamimin, publikimin në pronën komunale. Poashtu shtoi se edhe te qiraja e tregut ka realizim shumë të vogël në krahasim me planifikimin. Në fund tha se me rastin e planifikimit duhet të jemi realistë, e të mos bëhet planifikim i vogël, e pastaj të del se është realizuar dyfishi më shumë, prandaj kërkoi që planifikimi të jetë i bazuar.

Isuf Jashari- duke i mirëpritur të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet nga anëtarët e Kuvendit, tha se duhet patur paraysh se çdo herë kur të bëhet bëhet planifikimi, bëhet edhe plani dinamik për periudhën Janar-Dhjetor për çdo vit fiskal, pra në bazë të planit të rrjedhjes së parasë, bëhet edhe sambl i mjeteve dhe realizimi i mjeteve për periudha kohore. Në vazhdim tha se Drejtorja e Buxhetit në bazë të planifikimit

ka bërë alokimin e mjeteve dhe në çdo kategori ekonomike është flokuar buxheti, ashtu siç kanë kërkuar drejtorët e drejtorive dhe në procedura të rregullta ligjore është bërë zotimi i mjeteve në bazë të kërkesave të dërguara në Drejtorinë e Buxhetit dhe janë proceduar zotimet në bazë të modulit të blerjes në Drejtorinë e Prokurimit për procesim të mëtutjeshëm. Në vazhdim duke u përgjigjur në pyetjet a anëtarëve të Kuvendit, tha se janë disa kategori të cilat nuk janë realizuar mjetet, mirëpo mjetet e mbetura janë mjete të cilat janë në procedurë për realizim të mëtutjeshëm, dhe si shembull konkret përmendi pagat, kurse te mallrat dhe shërbimet, në muajin qershor ose korrik, arsimi bën zotimin e mjeteve për thëngjill, derivate dhe drunjë. Mandej te samblist është një shumë e vogël, e që të gjitha faturimet që kanë qenë deri në muajin qershor janë kryer zotimet, kurse kjo shumë ka mbetur për procedurë të mëtutjeshme. Ndërsa lidhur me subvencionet, tha se në bazë të planit dinamik janë realizuar. Mandej u pajtua me gabimet teknike që i paraqiti B.Jashari, duke premtuar që më nuk do të përsëritën, mirëpo në faqe nr. 7, tha se bëhet fjalë për një formular unik nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Kurse lidhur me gurthyesit, u përgjigj se nga ta merret vetëm taksa në firmë.

9. Propozimvendim për ridestinim të mjeteve buxhetore në shumë prej 86.000 €.

Isuf Jashari- paraqiti sqarimet hyrëse.

Bajram Mulaku- arsyetoi qëllimin e propozimvendimit për ridestinimin e shumës në fjalë.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi duke lejuar ridestinimin e mjeteve të lira të buxhetit të Komunës të vitit 2010, të mbetura nga projektet e realizuara kapitale në shumë prej 86.000 €. Këto mjete të ridestinuara do të shfrytëzohen për vazhdimin e asfaltimit të rrugës Vushtrri – Dobërllukë.

10. Shqyrtimi i informatës për suksesin e nxënësve në fund të gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2009/2010.

Qazim Azemi- tha se në Informatën në fjalë nuk ka informatë të plotë për suksesin nxënësve nëpër nivelet e shkollimit, apo për suksesin edhe të shkollave. Pastaj tha se tabelat e paraqitura në Informatë nuk janë të plota, duke shtuar se kishte me qenë mirë që tabelat në fjalë të krahasohen me vitin paraprak. Në vazhdim lidhur me suksesin e nxënësve, tha se është dashur që të përcillet jo vetëm në mënyrë të përgjithësuar, por të pasqyrohet sukcesi i nxënësve në secilën shkollë. Gjithashtu mungon paraqitja e suksesit të aktiviteteve të lira, mungon sukcesi i nxënësve në garat e matematikës në kuize të diturisë, në garat sportive. Mandej tha se mungon edhe sukcesi i semimaturantëve. Pastaj pyeti drejtorin e arsimit se çfarë sukcesi kanë mundur të kenë nxënësit e shkollës së mesme të ultë, nr. 2 (te spitali), pasi që 2 -3 javë ia kanë filluar procesit mësimor me vonesë, sepse shkolla ka qenë në ndërtim e sipër, poashtu për shkak të nxemjes i kanë humbur mbi një javë, dhe shtoi se në shkollën në fjalë nuk ka mundur të realizohet planprogrami siç duhet dhe sa duhet, pasi që nuk janë mbajtur as orët plotësuese. Në fund tha se nuk është në rregull që të kalohet pjesërisht me këtë Informatë sukcesi i nxënësve të të gjitha niveleve në shkollat tona, por të jetë më i analizuar dhe më i detajuar për secilën shkollë dhe për secilin nxënës.

Besim Jashari- fillimisht njoftoi se komentet për Informatën në fjalë po i paraqet në emër të grupit samblistë të LDK-së, dhe tha se drejtori i Drejtorisë së Arsimit me rastin e përgatitjes së kësaj Informate do të duhej t'i referohej ndonjë kërkesë, pasi që më herët V.Karaça ka bërë një kërkesë për informim lidhur me suksesin e nxënësve. Nga Informata e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, shihet se është shënuar

një ngritje e suksesit në krahasim me gjysmëvjetorin e parë, e që nëse do të ishte një përmirësim dhe ngritje cilësore, do të ishte shumë pozitive, duke shtuar se nëse ka ndodh kjo ngritje e suksesit, ka qenë obligim i Drejtorisë së Arsimit t'i jap arsytet se si është arritur kjo ngritje e suksesit, çfarë masash janë ndërmarrë, në mënyrë që ky sukses të argumentohet me parametra real. Në vazhdim duke iu referuar tabelave të paraqitura në Informatë mbi rezultatet e arritshmërisë në testin e maturës në shkollat e mesme, tha se më shumë se gjysma e nxënësve kanë treguar sukses negativ në testin e maturës, poashtu në bazë të këtyre tabelave, numri i mungesave është shumë i madh. Në fund i sugjeroi Drejtorisë së Arsimit që në të ardhmen kur të paraqiten informata të tilla, të jepen edhe komente dhe arsyeshmëri se sukseksi është ngritur si rezultat i masave të ndërmarra në aspekte konkrete.

Sabit Kadriu- duke iu referuar Informatës në fjalë, tha se është brengosëse pasi që në gjysmëvjetorin e parë kanë qenë mbi 70% të nxënësve me nota të dobëta, kurse tani është mbi 92% kalueshmëria. Pastaj tha se duhet të nxirret shkaqet e krijimit të një suksesit artificial, pasi që nuk ka sukses të natyrshëm, pasi që krahasimi në mes të dy gjysmëvjetorëve është treguesi më i mirë i gjendjes. Mandej tha se gjimnazi "Eqrem Qabej" nga viti në vit ka rënie në provimin e maturës, prandaj duhet analizuar pse po ndodh kjo rënie e kalueshmërisë. Në vazhdim tha se ngritja e godinave shkollore është shumë e rëndësishme, por nuk ngritet cilësia përdërisa nuk janë pagat e arsimtarëve në nivelin e kënaqshëm, nëse nuk plotësohen kushtet tjera, siç janë: laboratorët, bibliotekat, dhe shumë faktorë të tjerë. Pastaj tha se drejtori i arsimit do të duhej ta bënte një studim më të hollësishëm, e jo një Informatë pse po ndodh kjo rënie në arsim. Gjithashtu tha se për secilën shkollë duhet të bëhet një analizë në detaje, sidomos për shkollat e mesme. Në fund propozoi që të marrin fund ndërtimet e godinave shkollore, dhe të bëhet infrastruktura e këtyre shkollave, të pajisen shkollat me laboratorë, të furnizohen bibliotekat e shkollave me libra, të merren masa që kriteret e pranimi të nxënësve të respektohen deri në maksimum.

Melihate Basholli- duke e vlerësuar pozitivisht Informatën e paraqitur nga Drejtorja e Arsimit, tha se ngritja e suksesit në arsim duhet të lidhet ngushtë edhe me bashkëpunimin me prindërit dhe me kujdesin e prindërve për fëmijët e tyre. Pastaj duke iu referuar shkollës së mesme të ultë nr.2, tha se në atë shkollë është realizuar planprogrami, kanë humbur tri ditë mësim për shkak të ngrohjes, por ato janë zëvendësuar të shtunave. Në vazhdim sugjeroi që të zvogëlohet numri i nxënësve nëpër klasa në të gjitha shkollat, për shkak të zhvillimit më cilësor të arsimit.

Sami Istrefi- pasi që e përkrahu Informatën, tha se shqetësues është numri i mungesave të shumta nga ana e nxënësve. Mandej propozoi që të hartohet një strategji konkrete për ta ndryshuar taktikën e qeverisjes së arsimit në kuptimin më të mirë të mundshëm, që të krijohet afërsia mes prindit, nxënësit dhe familjes, pasi që ekziston një shkëputje në këtë drejtim.

Bajram Mulaku- duke iu referuar dallimit të suksesit nga gjysmëvjetori i parë në të dytin, tha se nuk është fenomen i ri, dhe nuk është një fenomen vetëm i Komunës së Vushtrrisë, por është një fenomen i vjetër, por duhet të analizohet dhe të identifikohen faktorët pse ndodhë kjo. Lidhur me suksesin në gjimnaz, tha se është brengosëse pasi që sukseksi në vazhdimësi është duke shënuar rënie, duke përmendur si një ndër komponentet faktin se në vitin e parë janë pranuar shumë më tepër nxënës, se sa që janë planifikuar, poashtu ka pasë paralele që kanë qenë 50 nxënës. Në vazhdim tha se sukseksi në arsim varet prej arsimtarit se me çfarë përgatitje shkon në orën mësimore, por varet edhe prej punës së nxënësit, se sa angazhohet, pastaj varet edhe nga përkushtimi i prindit se sa e përcjellë punën e fëmijut të vet, varet prej kujdestarit të klasës, poashtu varet edhe nga teknologjia informative dhe përdorimi i saj, pastaj prej bibliotekës, prej laboratorëve, prej punës jashtë orarit të mësimi.

Selvete Sholla- tha se në shkollat e mesme, sidomos në teknikë dhe profesionale ka një sukses dukshëm më të mirë se sa vitin e kaluar, sidomos tek maturantët, por ajo

që është brengosëse dhe apeloj tek drejtori i arsimit që të kërkohet dhe t'i kushtohet rëndësi e veçantë librave të shkollave të mesme, pasi që në shkollën e mesme teknike dhe profesionale me 6 profile të ndryshme, asnjë libër nuk është në shkollat në fjalë, por mësimi zhvillohet përmes diktimit, dhe kërkoi nga drejtori i Arsimit dhe Kryetari i Komunës që këtë problem ta shqyrtojnë në nivele më të larta, dhe shtoi se asnjë libër nuk është në gjuhën shqipe për lëndët profesionale.

Qerim Selimi- lidhur me Informatën në fjalë, tha se ka bërë përpjekje që të paraqiten të dhënat në formë tabelare, duke i shoqëruar edhe me komente suksesin e këtij viti me gjysmëvjetorin e parë dhe përfundimin e këtij viti me vitin e shkuar kalendarik. Mandej tha se nëse analizohet sukseksi i gjimnazit me vitin e kaluar, provimin e maturës, atëherë del sukses pozitiv në të gjitha drejtimet, përveç drejtimit gjuhësor. Pastaj tha se është bërë investim në infrastrukturë, dhe si fakt përmendi zhvillimin e procesit mësimor vetëm në dy ndërrime, mirëpo investimet në të ardhmen kërkohen të bëhen në ngritjen e cilësisë, por ngritja e cilësisë arrihet me marrjen e masave konkrete. Në vazhdim njoftoi se që dy vite asnjë nxënës që përfundon shkollën fillore, nuk ka mbetur pa u përfshirë në shkollat e mesme, dhe kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të nxënësve nëpër paralele. Pastaj lidhur me suksesin e nxënësve, tha se sa është brengosës, është edhe i kënaqshëm, sepse është sukses real, gjithashtu është shqetësues edhe numri i mungesave. Në vazhdim bëri të ditur se në këtë Informatë nuk janë të përfshirë nxënësit serbë, dhe prej muajit Janar të vitit të kaluar nuk i paguajnë mësimdhënësit serbë, pasi që ata nuk sjellin asnjë informatë në Drejtorinë e Arsimit dhe nuk bashkëpunojnë me Drejtorinë e Arsimit.

11. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e pronave të pa luajtshme.

Nezir Klinaku- paraqiti sqarimet hyrëse.

Ismet Gashi- lidhur me propozimvendimin në fjalë tha se aktvendimi që është i bashkangjitur me materialin, nuk është aktvendim që është bërë ndërrimi, por është aktvendim për ndarje fizike bashkësisë familjare ekonomike, që nuk ka të bëjë me ndërrim fare, por nëse ekzistojnë fakte që është bërë ky ndërrim në gjykatë dhe ai vendim është i formës së prerë, atëherë nuk ka nevojë Kuvendi të marrë vendim të ri, por vetëm le të zbatohet vendimi që e ka aprovuar në atë kohë gjykata, mirëpo nëse nuk i ka ato dokumentacione, dhe nëse kërkohet nga drejtoria përkatëse që të bëhet ndërrimi vetëm me një shkresë të palës, pa një kopje të letërnjoftimit të palës, pa një vlerësim të ekspertëve, prandaj shtoi se është dashur të ketë një vlerësim të ekspertëve. Në fund tha se grupi samblistë i LDK-së nuk do ta përkrah propozimvendimin në formën e tillë.

Nezir Klinaku- tha se po të ishte vendimi i gjykatës, nuk do të paraqitej nevoja që të kërkohet aprovimi i propozimvendimit në Kuvend. Pastaj shtoi se ndërrimi në fjalë ari për ari është në interes të Komunës për projektin e lumit "Tërstenka", mirëpo në terren prej vitit 1974 e deri më sot, prona e Izet Krasniqit është trotuar.

Muharrem Shabani- tha se çdo çështje për interesin publik merren disa veprime tjera, kurse në rastin konkret nuk do të duhej të merrej një përgjegjësi e tillë, pa e shpallur si interes që i nevojitet Komunës një pjesë e kësaj parcele, pra së pari të merret vendimi, dhe pasi që të merret vendimi bëhet një vlerësim përkatës, dhe poashtu të dihet sa e ka vlerën prona e Komunës që po i jepet.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 16 vota "për", 14 "kundër", 1 "abstenim" lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi i cili lejon ndërrimin e patundshmërive në mes të Komunës së Vushtrrisë në njërën anë, dhe Izet Krasniqit nga Vushtrria në anën tjetër.

12. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjopa komunale.

Nezir Klinaku- paraqiti sqarimet hyrëse.

Ismet Gashi- tha se grupi samblistë i LDK-së e përkrah propozimvendimin në fjalë, por kërkon nga Kryetari i Komunës që sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale ta bën përgatitjen me bashkëpunëtorët e vet për një rregullore përmbledhëse për tarifa dhe taksa për seancat e ardhshme.

Muharrem Shabani- tha se grupi samblistë i AAK-së e përkrah propozimvendimin, duke propozuar që të futet edhe një kategori, pasi që është obligim moral dhe njerëzor, pra personat që marrin ndihma sociale.

Sami Istrefi- pyeti se sa ka qenë numri i kërkuesve i këtyre kategorive në gjashtëmujorin e parë për nxjerrjen e këtyre dokumentacioneve, duke përkrahur që të futet edhe kategoria e personave që janë në asistencë sociale.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi i cili plotëson dhe ndryshon Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01Nr.742/08, dt. 30.12.2008, duke ia shtuar nenit 36, paragrafit 1, këtë përmbajtje:

Nga pagesa për shërbimet e kryera: për certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme (fletë poseduese), kopje të planit certifikata dhe vërtetime lirohen:
a. Familjet e dëshmorëve të luftës së UÇK-së, Invalidët e luftës së UÇK-së, Veteranët e luftës së UÇK-së, si dhe familjet dhe individët, përfitues të ndihmave sociale.

13. Shqyrtimi i propozim – marrëveshjes për ndërrim të pronave të paluajtshme.

Nezir Klinaku- paraqiti sqarimet hyrëse.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, 14 “kundër”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet marrëveshja për ndërrim të pronave të paluajtshme në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe KEK Sh.A. , në Prishtinë, për implementim të projektit për rregullimin e shtratit të lumit “Tërstena” në qytetin e Vushtrrisë.

Sqarim: grupi asambleistë i AAK-së ka votuar “kundër”.

14. Shqyrtimi i propozim-vendimit për lejim të mjeteve financiare për pagesë të shujtës për shërbyes civil të Administratës së Komunës.

Refik Ramaj- tha se grupi samblistë i LDK-së është pro të gjitha formave të stimulimit të shërbyesve civil në mënyrë që të jenë më produktiv, dhe duke e mbështetur propozimvendimin në fjalë, kërkoj që të konstatoj Komuna se nuk ka shkelje ligjore.

Sami Istrefi- e mbështeti propozimvendimin për stimulimin e shërbyesve civil të Komunës, duke rikujtuar se edhe në seancën e kaluar ka kërkuar që të stimulohen shërbyesit civilë të Komunës, ashtu siç ka bërë edhe Komuna e Prishtinës. Pastaj shtoi se edhe në KPF ka kërkuar që propozimvendimi të vjen me ndryshime, por nuk ka ardhur, pasi që propozuesi duhet të jetë Drejtoria e Administratës dhe Personelit, e jo Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Në vazhdim duke iu referuar dispozitave ligjore, tha se në vend të nenit 12.2, duhet të jetë neni 13 dhe neni 58 mbi vetëqeverisjen lokale. Kurse në nenin 2 propozoi që të specifikohet më konkretisht pagesa e mjeteve të cekura në nenin paraprak të bëhet nga të hyrat vetanake të buxhetit të Komunës. Kurse tek neni 1, kërkoj që të specifikohet qartë, duke propozuar që neni në fjalë t'i shtohet edhe fjalia: “punëtorët e drejtorive të Komunës”.

Habib Mustafa- kërkoj që të përfshihen në propozimvendimin në fjalë edhe shërbyesit civil të shkollave.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 29 vota “për”, 1 “kundër”, 1 “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
Aprovohet vendimi në fjalë, me të cilin nga buxheti i Komunës lejohen mjete financiare në vlerë prej 2 (dy) € në ditë, përkatësisht 44 € (dyzetëekatër euro) në muaj, për pagesë të shujtës për shërbyesit civil të administratës së komunës, duke filluar nga data 01.04.2010.

Në vazhdim u diskutuan bashkarisht këto dy pika të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira për renovimin e objektit të komunës.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi i cili lejon ridestinimin e mjeteve të lira të buxhetit të Komunës për vitin 2010, të mbetura nga projektet e realizuara kapitale – ndërtimin i infrastrukturës rrugore, nga kodi 81153 në kodin 31149, projekti për renovimin e objektit të Komunës. Vlera e mjeteve të ridestinuara është 36.124.00 €.

16. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për ridestinim të mjeteve – shuma 9.800.00 €, për furnizim me orendi për zyrën e kryetarit.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi që lejon ridestinimin e mjeteve të buxhetit të Komunës në shumë prej 9.800.00 € nga projekti “ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe trotuarëve” përkatësisht nga programi buxhetor – planifikimi urban dhe mjedisi, në projektin “blerja e orendive të KK-së”.

17. Eventuale:

a. Informatë për furnizimin me ujë të pijshëm.

Dibran Përçuku- tha se në mbledhjen e parafundit si drejtori në detaje ka paraqitur një Informatë për furnizimin me ujë të pijshëm. Mandej shtoi se brenga është e përgjithshme lidhur me mungesën e furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë qytetarët. Në vazhdim bëri të ditur se ka shumë faktorë që ndikojnë për furnizim me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë, duke filluar prej keqpërdorimeve të jashtëzakonshme edhe në Komunën tonë, pastaj ka keqpërdorime edhe në gypin magjstral, pasi që ka kyçje ilegale, të cilat nuk ka mundësi të evitohen, pasi që ato kyçje janë bërë nga matrapazët e ndryshëm në kohën e okupimit, por as ujesjellësi rajonal dhe as bordi nuk kanë instrument që mund të identifikojnë kyçjet ilegale që janë bërë, duke filluar nga Shipoli e deri në Komunën tonë. Pastaj tha se probleme me furnizim me ujë të pijshëm do të ketë deri sa të ndërtohet fabrika e ujit. Gjithashtu falënderoi bordin e ri të ujesjellësit, duke shtuar se ardhja e tyre ka bërë përmirësime të dukshme në favor të qytetarëve të Vushtrrisë në drejtim të furnizimit më të madh me ujë të pijshëm, në krasahasim me vitet paraprake.

b. Informatë për fushatën e korrje-shirjeve.

Nasuf Aliu- njoftoi se korrje-shirjet kanë zgjatur dy javë, kurse kanë qenë të angazhuara 52 autokombaja vendore nga komuna jonë, dhe 20 autokombaja nga komunat e periferisë. Pastaj njoftoi se me grurë kanë qenë të mbjellura 350 hektarë, tërshinë 180 hektarë, elb 195 hektarë, gjithsej kanë qenë 3.875 hektarë të mbjellura, dhe në përgjithësi procesi ka shkuar mirë, me përjashtim të tërshërës, që pjesërisht ka mbetur pa u përfunduar procesi, për shkak të kushteve klimatike. Lidhur me rendimentin, tha se tek gruri ka pasur mesatarisht 4 ton për hektarë, në tërshërë 2.8 ton për hektarë, kurse tek elbi 3.2 ton për hektarë.

c. Çështja e Spitalit në Vushtrri.

Muharrem Shabani- tha se gjendja nuk mund të ndërrohet në spital dhe nuk ka askush të drejtë sepse spitali është pronë e Komunës së Vushtrrisë, prandaj pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë nuk ka të drejtë askush të ndërhy në spital. Gjithashtu tha se është interes i Komunës së Vushtrrisë të vazhdon punën spitali siç ka punuar deri më tash. Në vazhdim njoftoi se rruga në fshatin Samadrexhë dhe në drejtim të Cecelisë dhe Sllakovcit është gati e shkatërruar për shkak të shfrytëzimit të rrugës me pesha dhe mbipesha të pakontrolluara.

Sami Istrefi- tha se grupi asambleistë i PDK-së mbështet qëndrimin e anëtarit të Kuvendit P. Pllana, që spitali në fjalë që në asnjë formë të mos lejohen të bëhen pazarllëqe në pronat tona, që i menaxhon ky Kuvend dhe kjo Komunë.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi këtë:

D e k l a r a t ë

- 1. Kuvendi i Komunës shpreh mospajtim dhe është kundër mundësisë së fillimit të procedurave të partneritetit publiko-privat të spitalit "Sheik Zayed" në Vushtrri, apo çfarëdo forme tjetër të tjetërsimit të tij.***
- 2. Spitali në Vushtrri është themeluar në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar më, 26.11.2001 në mes të Emirateve të Bashkuara Arabe e cila e ka financuar këtë spital, Komunës së Vushtrrisë, UNMIK-ut dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Në bazë të këtij memorandumit ky spital është në pronësi të Komunës së Vushtrrisë dhe si i tillë nuk mund të epet me qera, gjegjësisht nuk mund të tjetërsohet apo ndërmerret ndonjë procedurë tjetër që e ven në pyetje pronësinë.***
- 3. Kuvendi i komunës ndan shqetësimin me Sindikatën e punëtorëve, këshillin profesional të spitalit dhe i përkrah reagimet e tyre dhe kundërshtimet për mundësinë e ndërmarrjes së hapave siç pretendohet nga Ministria e Shëndetësisë, lidhur me të cekurat më sipër.***
- 4. Kuvendi i komunës konsideron se çdo veprim që ka të bëjë me ndërrim të statusit të spitalit do të kundërshtohet në plotëni dhe do të jetë i pa pranueshëm për Komunën e Vushtrrisë.***
- 5. Lidhur me këtë të njoftohen organet përkatëse kompetente në Republikën e Kosovës.***

ç. Kërkesë për ngritje të kompensimit mujor për anëtarët e Kuvendit Komunal.

Ferit Idrizi- tha se është i pakënaqur pasi që është një pagë injoruese për anëtarët e kuvendeve komunale, nëse krahasohen me pagat e deputetëve të Parlamentit të Kosovës.

Bahrije Pllana- propozoi që të formulohet një kërkesë për ndryshimin e udhëzimit administrativ me të cilin rregullohet pagesa e delegatëve të kuvendeve komunale, dhe të shprehet në proporcion 1 me 3 në raport me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e jo në shuma fiske siç ka qenë deri më tani. Pastaj në bazë të informatave që kishte, njoftoi se delegatët e kuvendeve komunale, në raport me

delegatët rajonal, paguhemi më së paku. Gjithashtu propozoi që kjo iniciativë të inicohet edhe në Asociacionin e kryetarëve dhe kryesuesëve të komunave të Kosovës.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet kërkesa në fjalë e cila i drejtohet Kryeministrit të Kosovës dhe Ministrit për Ekonomi dhe Financa për shqyrtim.

d. Pyetjet eventuale të anëtarëve të Kuvendit.

Besim Jashari- kërkoi nga Drejtoria për Shërbime Publike që një pjesë e rrugës “Dëshmorët e Kombit” të mbyllet, dhe të bëhet shetitore vetëm për këmbësorët, pasi që ka qarkullim jashtëzakonisht të madh. Pastaj kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që në seancën e radhës të sjellë një Informatë lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, për përgatitjet për nxemje, dhe për sigurimin e ngrohjes. Mandej lidhur me drunjët dekorativ, sugjeroi që në të ardhmen nëse parashihen të mbjellen, të ketë kujdes pasi që kah Shkolla e Policisë në disa vende janë mbjellë drunjët nën drunjë. Në fund kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që pjesa e rrugës “Skënderbeu” prej kryqëzimit kah ambulanta, pjesa kah rrethoja e policisë, kërkoi që një breg me bari në rrugën në fjalë të rrafshohet në mënyrë që të zgjerohet trotuari dhe të ecin njerëzit më sh lirë.

Makfirete Ademi- kërkoi informatë të hollësishme lidhur me atë se sa është numri i bizneseve në tërësi në Komunën tonë dhe sa prej tyre kanë leje komunale, pasi që ka edhe punëtorë të institucioneve të cilët nuk kanë leje komunale. Mandej kërkoi informatë të hollësishme se sa kanë kushtuar takimet e poeteshave këtë vit, pasi që vitin e kaluar ka pasë shpenzimet mëdha, dhe janë paguar edhe organizatorët, e që nuk është dashur të paguhen, ngase ata marrin paga.

Mbledhja përfundoi në orën 18:05.

**Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi**